

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË POGRADEK

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Pogradec**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 02.06.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1204/9 datë 02.06.2015, i ka rekomanduar z. Luan Maxhari Pogradec, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa për zbatimin e detyrave të pa realizuara sipas rekomandimeve dërguar me shkresën nr. 942/11, Prot, datë 31.12.2012 të *Kontrollit të Lartë të Shtetit*, të rikërkua me shkresën nr. 437/52, datë 31.07.2013 të *Kontrollit të Lartë të Shtetit*.

I. Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **3,019,999** lekë për rekomandimet 2,3 dhe 4 (**1,381,985, 1,400,000 +238,014**), si dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, si më poshtë:

2. Gjetje nga auditimi: Me kontratën e qirasë datë 28.04.2004 lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe V.Zh, në cilësinë e enfiteozmarrësit, është dhënë me enfiteozë një sipërfaqe truall prej 55 m², me qëllim ndërtimin e një lokali brenda territorit të bashkisë, kontratë e cila nuk ka të përcaktuar afatin por vetëm kushtin se afat të vlefshmërisë së saj, deri në momentin e shlyerjes së investimit të bërë nga enfiteozmarrësi. Në hartimin e kontratës Bashkia, nuk i është referuar kuadrit ligjor të kohës dhe konkretisht VKM nr. 315, datë 24.04.2004 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”. Nga mos përllogaritja e vlerës së investimit për ndërtimin e objektit, duke mos mbështetur në koston e ndërtimit për qytetin e Pogradecit, ku sipas UKM nr. 1, datë 04.03.2004, kostoja ka qenë e përcaktuar në vlerën 25,069 lekë/m², vlera e tij është ritur në mënyrë fiktive. Kosto e ndërtimit për sipërfaqen prej 55 m², duke përfshirë edhe 6 zëra punimesh sipas preventivit të cilat janë punime ekstra (zëri 16, 17, 21, 22, 32 dhe 40) arrijnë në vlerën 700,000 lekë, ku vlera totale e objektit ndërtim do të ishte jo më e madhe se 2,081,985 lekë, pra nga përllogaritja e vlerës reale të objektit, ***bashkisë i krijohet një e ardhur e munguar në vlerën prej 1,381,985 lekë***.

Rekomandim: Bashkia Pogradec të kërkojë në rrugë ligjore, shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **1,381,985 lekë**, nga enfiteozëmarrësi **V.Zh**, si dhe të marrë masat e mëposhtme:

a. Të rishikohet në themel baza ligjore e hartimit dhe lidhjes së kontratës datës 28.04.2004 e llogaritur për 24 vjet, kushtet e përcaktuara në të, si dhe të administrohet gjithë dokumentacioni ligjor (sipas legjislacionit tatimor) për nxjerrjen e vlerës reale të investimit.

b. Për periudhën që lokali ka qenë në përdorim të z. V.Zh, të rillogariten detyrimet e taksave vendore, duke njoftuar edhe Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Korçë.

c. Të saktësohet dhe azhurnohet, e gjithë pasurinë e paluajtshme truall dhe ndërtesë, pasi të hartojë planimetrinë dhe planrilevimin përkatës,

ç. Të kërkohet nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, regjistrimin e tij në pronësi të bashkisë, në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme dhe nëse nuk paraqitet dokumenti i regjistrimit në QKR, të fillojnë procedurat ligjore për prishjen e kontratës.

3. Gjetje nga auditimi: Në transaksionet nr. 69, datë 11.02.2013, në vlerën 800,000 lekë dhe nr. 291, datë 08.08.2014, në vlerën 600,000 lekë me objekt: kontribut në Shoqërinë Aksionare “Administrimi i Mbetjeve Urbane të Qarkut Korçë” me NIPT: K84227001O, u konstatua se Vendimet e Këshillit të Bashkisë Pogradec nr. 7 date 18.01.2013 dhe nr. 7, datë 31.01.2014 për pagesat (kontribute në shoqëritë aksionare me kapital privat) në vlerën 2.300.000 lekë, për vitin 2013 dhe 3.400.000 leke për vitin 2014, janë miratuar në tejkalim të juridiksionit territorial të Bashkisë Pogradec. Veprime këto, në kundërshtim me shkronja “B”, paragrafi I, nenin 8, të ligjit nr. 8562, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Kjo pasi sipas kësaj dispozite, një njësi e qeverisjes vendore, nuk mund të miratojë akte që e shtrijnë fuqinë e tyre në një territor të një njësie tjetër të Qeverisjes Vendore, për pasojë vlera e likuiduar për vitet 2013, 2014, prej **1,400,000 lekë**, përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga ana e Shoqërisë së Administrimit të Mbetjeve Urbane” .

Rekomandim: Bashkia Pogradec të kërkojë në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit ekonomik prej **1,400,000 lekë**, ndaj operatorit ekonomik “Administrimi i Mbetjeve Urbane të Qarkut Korçë”, sa është paguar padrejtësisht nga fondet e buxhetit të Bashkisë Pogradec, pa kryer asnjë shërbim, mall apo punë. Të ndjekë procedurat ligjore për të kryer revokimin e dy vendimeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec (VKB nr. 7, datë 18.01.2013 dhe nr. 7, datë 31.01.2014), mbi kontributet në këtë subjekt privat **në vlerën 4,300,000 lekë**.

4.Gjetje nga auditimi: Është paguar z.K.Gj, me detyrë Kryeinspektori i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë, me diplomë “Bachelor në Shkenca” datë 24.10.2007 të marrë në Universitetin Amerikan të Athinës, dega Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri Përqendruar në Inxhinieri Civile. Megjithëse kanë kaluar mbi 1 vit e 8 Muaj nga data e emërimit 29.07.2013 dhe deri më datën 10.05.2015, nuk ka paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, dokumentin e Njehsimit të Diplomës. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007”Për Arsimin e Lartë në R.SH” , i ndryshuar me ligjen nr. 9832, datë 12.11.2007 dhe nr.10 307, datë 22.7.2010, neni 1, i ndryshuar me nenin 37 “Njohja e diplomave,certifikatave, gradave dhe titujve të huaj”. Ky punonjës është paguar si specialist i lartë me pagë neto 46,500 lekë/muaj, kur duhej të paguhej si specialist i mesëm me pagën neto 24,864 lekë/muaj, si pasojë për të gjithë periudhën e audituar Korrik 2013-31.12.2014, ka përfituar padrejtësisht vlerën e arkëtueshme **prej 238,014 lekë** .

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **238,014 lekë** nga z. K.Gj me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë, si diferenca page e paguar tepër (nga arsim të mesëm në arsim të lartë). Ndërkohë, duke filluar që nga data 01.01.2015 deri në paraqitjen e dokumentit fizik të Diplomës së njehsuar të rillogaritet diferenca e pagesës e të arkëtohet, si të paguhet me pagën e punonjësit me arsim të mesëm.

5. Gjetje nga auditimi:Për periudhën e audituar në sektorin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Pogradec, është konstatuar se nga mos arkëtimi i detyrimeve të trashëguara nga viti 2012 deri më datë 31.12.2014, janë krijuar debitorë në vlerën **100,158,000 lekë**, si më poshtë:

- taksën e biznesit të madh nga 16 subjekte në vlerën 1,424,000 lekë,
- taksën e biznesit të vogël nga 194 subjekte në vlerën 2,213,000 lekë,
- taksën e ndërtesës gjithsej në vlerën 17,677,000 lekë e detajuar për 10,340 familje në vlerën 10,556,000 lekë dhe nga 210 subjekte biznesi në vlerën 7,121,000 lekë,
- tarifën e pastrimit e detajuar për 10,340 familje në vlerën 26,116,000 lekë dhe nga 210 subjekte biznesi në vlerën 13,716,000 lekë,
- tarifën e gjelbërimit e detajuar për 10,340 familje në vlerën 14,449,000 lekë dhe nga 210 subjekte biznesi në vlerën 7,181,000 lekë,
- tarifën e ndriçimit e detajuar për 10,340 familje në vlerën 16,773,000 lekë dhe nga 210 subjekte biznesi në vlerën 609,000 lekë.

Shënim: Gjatë periudhës së kthimit të Projektraportit të auditimit deri më datën 10.05.2015 u arkëtuan nga 50 debitorët e taksave vlera prej 2,000,000 lekë.

Rekomandim: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Taksave e Tarifave Vendore dhe Ujësjetës shp. si agjent tatimor, të marrë masa për evidentimin e debitorëve kontabilizimin e detyrimeve të pa likuiduara, deri më datën 31.12.2014 në vlerën **100,158,000 lekë**, përkatësisht, të mbartura nga viti 2012 në vlerën 21,298,000 lekë, nga viti 2013 në vlerën 28,761,000 lekë, nga viti 2014 në vlerën 50,099,000 lekë dhe për vjeljen e tyre nga ana e Bashkisë Pogradec, të veprohet si më poshtë:

a-Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

b-Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e bares siguruese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

c-Në rast se subjektet edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në Bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, dt.4.12.2014, pasi të vendosen masa administrative gjobë e barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë kalendarike, të kërkohej kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pikat 130-132 të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008" Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit Penal i R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve .

c. Bashkia Pogradec të marrë masa për saktësimin e dhomave me qera dhe për hotele (turizmin familjar), veçanërisht për territorin rreth liqenit Pogradec, duke ngritur një grup pune me pjesëtarë të Drejtorisë Financës në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Drejtorinë e Planifikimit Territorit, me qëllim evidentimin dhe përlllogaritjen e taksave ndaj personave, të cilët ushtrojnë turizëm familjar në sezonin e plazhit.

6. Gjetje nga auditimi: U konstatua se lëvizja e punonjësve të administratës së Bashkisë dhe Institucioneve e Ndërmarrjeve në varësi të saj, si transferimi brenda Bashkisë, apo largimi i tyre nga puna, është bërë pa dorëzuar më parë detyrën me procesverbal. Veprime këto në kundërshtim me pikën 13, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", VKM nr.7, datë 09.01.1976 "Për dorëzimin e detyrës midis punonjësve", pikat 19, 20 dhe 21 të VKM nr.360, datë 14.07.2000 "Për lirim nga shërbimi civil" dhe pikën 50 të VKM nr.171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil".

Rekomandim:Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa, që në të gjitha rastet lëvizjet e punonjësve të administratës së Bashkisë dhe institucioneve e ndërmarrjeve në varësi të saj, si transferimi nga një Drejtori dhe Sektor, në një tjetër brenda Bashkisë, apo largimi i tyre nga puna të bëhet duke dorëzuar detyrën me procesverbal, sipas kërkesave të përcaktuara në dispozitat nënligjore të cituara më sipër.

7. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit dhe Organizimit të Bashkisë, është miratuar para 12 vjetëve me Vendimin e Këshillit Bashkiak Pogradec nr. 52, datë 27.11.2003, ndërkohë që në të nuk janë parashikuar detyrat e Policisë Bashkiake, Sektorit Strehimit, etj. Gjatë kësaj periudhe janë krijuar dhe mbyllur mjaft sektorë dhe Drejtori, ku detyrat e tyre, nuk janë pasqyruar në rregulloren aktuale dhe nuk i përgjigjen strukturës dhe organigramës aktuale. Duke qenë shumë se Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Pogradec, nuk ka element të ligjit për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin .

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, për përfundimin e Rregullores së Brendshme të Bashkisë, duke pasqyruar të gjitha ndryshimet dhe përshtatur me strukturat dhe organigramën aktuale.

8. Gjetje nga auditimi: Nga ana e IMTV Pogradec, nuk janë trajtuar si letra me vlerë dhe nuk janë dërguar zyrtarisht në zyrën e financës, Vendimet për dënim me gjobë, si dhe nuk është bërë shoqërimi i

dorëzimit të tyre me proces verbal nga një punonjës tek tjetri. Mos dërgimi në zyrën e financës të vendimeve të gjobave nga vitet e mëparshme, kanë lënë shteg për abuzim dhe keqadministrim të tyre.

Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm i Bashkisë Pogradec në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të kryejnë auditimin tematik për gjobat e vendosura nga IMTV Pogradec, për periudhën që nga krijimi i kësaj strukture në vitin 2007, duke i pasqyruar në kontabilitet dhe ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e tyre dhe nxjerrjen e përgjegjësisë, për rastet e kalimit të afateve të parashkrimit.

9. Gjetje nga auditimi: Policia Bashkiake nuk ka arkëtuar 13 gjoba në vlerë 16,500 lekë, të vendosura gjatë periudhës së auditimit 2013-2014, në kundërshtim me pika 2, neni 14 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe pikat 9, 22, 30 dhe 44 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Rekomandim: Policia Bashkiake të marrë masat për arkëtimin e 13 gjobave të pa arkëtuara në vlerën 16,500 lekë.

10. Gjetje nga auditimi: U konstatua se me asnjë prej punonjësve të policisë nuk është lidhur kontratë pune para emërimit në detyrë për një periudhë jo me pak se tre-vjeçare, në kundërshtim me kërkesat e Rregullores së Brendshme "TIP" të Policisë Bashkiake e të Komunës të miratuar me Urdhrin e përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit, nr. 1 datë 17.04.2003, pika 7.

Rekomandim: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit, Bashkia Pogradec duhet të hartojë dhe të lidhë kontratat individuale të punës me të gjithë punonjësit e policisë bashkiake, sipas kërkesave të Rregullores së Brendshme "TIP" të Policisë Bashkiake e të Komunës.

11. Gjetje nga auditimi: Blloqet e vendosjes së gjobave të Policisë Bashkiake Pogradec, nuk janë trajtuar si letra me vlerë, nuk është bërë shoqërimi i dorëzimit të tyre me proces verbal nga një punonjës tek tjetri, ato gjenden fizikisht në duart e punonjësve të policisë bashkiake, por nuk janë bërë hyrje në magazinë. Nuk ekziston dokumentacion zyrtar se nga janë marrë në kundërshtim me VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 për “Shtypjen e letrave me vlerë” i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 6.4.2011 dhe pika 2, VKM nr. 393 datë 18.06.2014.

Rekomandim: Inspektori i Policisë Bashkiake të marrë masa që për çdo rast të lëvizjes së punonjësve të Policisë Bashkiake, të bëhet dorëzimi dhe marrja e blloqeve në dorëzim nga njëri punonjës tek tjetri me procesverbal. Magazinierja e institucionit të bëjë hyrje, të gjitha blloqet e ardhura në magazinë dhe të bashkëngjisë dokumentacionin e origjinës dhe blerjes së blloqeve.

12. Gjetje nga auditimi: Vendosja e gjobave nga Policia Bashkiake për 2 vitet 2013 -2014 është bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 02.02.2001 “Mbi miratim të urdhërësës së Këshillit Bashkiak”, për kategorinë e gjobave. Vendim i cili është mbështetur në ligjin nr. 7669, datë 07.04.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, dispozitë ligjore kjo e shfuqizuar me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Rekomandim: Zyra e Tatim-Taksave në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit, duhet të paraqesin në Këshillin Bashkiak Pogradec, materialin për rishikimin e vendimit mbi kategorinë e gjobave dhe masën e tyre, duke u mbështetur në nenin 6 dhe 10 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrativ”.

Në ndërmarrjet e vartësisë.

13. Gjetje nga auditimi: Nga nëpunësit autorizues dhe zbatues të Qendrës Kulturore -“Lasgush Poradeci”, Ndërmarrjes së Gjellbërimit, sektorit Mbështetës i Arsimit, Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës dhe Klubit Shumësportesh, nuk janë ngritur komisionet e marrjes në dorëzim dhe nuk janë hartuar procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me pikat 42,43,52 dhe 54 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Për blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat në njësitë shpenzuese, duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si: procesverbali i

firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit, etj.

14. Gjetja nga auditimi: Nga Qendra Kulturore-Lasgush-Poradeci, ndërmarrja e Gjellbërimit, sektori Mbështetës i Arsimit, Rinisë, Kulturës dhe Sporteve, ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës dhe Klubi Shumësportesh, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk kanë hartuar politikat, objektivat, planet strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

Rekomandimi: Njësitë shpenzuese në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të hartojnë politikat, të miratojnë objektivat e njësive publike, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

15. Gjetje nga auditimi: Njësitë shpenzuese në vartësi të Bashkisë, nuk kanë hapur regjistrë të aktiveve të qëndrueshme, ku të pasqyroheshin të dhënat e nevojshme si data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, sipas kërkesave të përcaktuara në Kap. III-të, i UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” .

Rekomandim:Njësitë shpenzuese në vartësi të Bashkisë, respektivisht: Qendra Kulturore-Lasgush Poradeci, Ndërmarrja e Gjellbërimit, Sektori Mbështetës i Arsimit, Rinisë, Kulturës dhe Sporteve, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës dhe Klubi Shumë Sportesh, të marrin masa për hapjen e regjistrit të aktiveve dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre, të regjistrojnë dhe përditësojnë të dhënat, për ndryshime në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi.

16. Gjetje nga auditimi: Njësitë shpenzuese në vartësi të Bashkisë, nuk kanë zbatuar ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Rregulloren “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”, për “Normat tekniko-profesionale-metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Rekomandim:Të gjitha njësitë shpenzuese në vartësi të Bashkisë, të kryejnë inventarizimin e brendshëm të dokumentacionit, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

17. Gjetje nga auditimi: Klubi Shumë Sportesh, të gjitha transaksionet e kryera për periudhën objekt auditimi faturat e thjeshtë tatimore apo faturat tatimore të shitjes me TVSH, nuk i ka shoqëruar me faturë të printuar nga kasa elektronike fiskale, në kundërshtim me Seksionin II, Pajisjet fiskale, neni 55-Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë” .

Rekomandim: Klubi Shumë Sportesh të marrë masa, që në të gjitha rastet e pagesave për udhëtim e dieta, të vlerësojë dokumentet që paraqiten(biletë transporti të miratuar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe çdo faturë e thjeshtë apo me TVSH,) të cilat detyrimisht, duhet të shoqërohet me faturë të printuar nga kasa elektronike fiskale sipas kërkesave ligjore.

18. Gjetje nga auditimi: Bashkisë Pogradec, megjithëse pronat i janë transferuar në pronësi me VKM nr. 1240, datë 10.09.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pogradec të Qarkut Korçë”, ka dërguara për regjistrim me shkresë nr. 260, datë 30.03.2014 vetëm disa objekte ndërtimore. Ndërsa, për të gjitha objektet e tjera nuk ka kryer regjistrimin e tyre në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Rekomandimi:Bashkia Pogradec të saktësojë dhe azhurnojë të gjitha pasuritë e paluajtshme të kaluara në pronësi, me VKM nr. 1240, datë 10.09.2008, si dhe të hartojë planimetritë apo plan rlevimet përkatëse, duke kërkuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, regjistrimin e tyre në pronësi të Bashkisë Pogradec.

19. Gjetje nga auditimi:Në kontratën e qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Administratorit të “E...P...M...” shpk, në cilësinë e qiradhënësit dhe “B....-A...” shpk në cilësinë e qiramarrësit, u konstatua se Genplani apo Planimetria e cila i bashkëlidhet asaj, nuk është miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Kjo ka sjellë mos dokumentimin teknikisht sipërfaqen e marrë në përdorim nga shoqëria, si dhe nuk është kryer “*Monitorimin e Kontratës*” dhe “*Ndjekja në vijimësi e respektimit të kushteve të kontratës*”. Për këtë objekt, nuk ka asnjë akt rakordimi me subjektin qiramarrës, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 13.02.2014. Për këtë objekt Bashkia Pogradec, nuk ka kërkuar pranë ZVRPP që të kryhet regjistrimi i truallit dhe objektit, kur aktualisht sipas Kartelës së Pasurive të Paluajtshme të ZVRPP Pogradec, rezulton se objekti i dhënë me qira, është pjesë e pasurisë nr. 9/107, regjistruar në vol. 19, faqe 180, zona kadastrave 8581, nga ku trualli është 2867 m² dhe objekti po 2867 m², dhe sipas librit të ngastrave kjo pasuri është me pronar shtet .

Rekomandimi:Bashkia Pogradec të saktësojë dhe azhurnojë, të gjithë pasurinë e paluajtshme truall dhe ndërtesë dhe pasi të hartojë planimetritë apo planrilevimet përkatëse, të kërkojë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, regjistrimin në pronësi të bashkisë, në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme.

20. Gjetje nga auditimi:Bashkisë Pogradec me VKB nr. 22, datë 30.3.2012 “Për miratimin e listës paraprake të pyjeve dhe kullotave, që kërkohen të transferohen në pronësi të Bashkisë Pogradec”, ka miratuar inventarin e fondit pyjor e kullosor, me qëllim për të kërkuar që ti kalojnë në pronësi nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, 25 ngastra, me sipërfaqe totale prej 895.65 ha.

Sipas dokumentacionit sipërfaqja prej 262.75 ha janë në mbrojtje dhe 632.9 ha me funksion përdorimi për dru zjarri, por deri më datën 10.05.2015, Bashkia Pogradec nuk ka kryer asnjë procedurë të mëtejshme për kalimin dhe marrjen në dorëzim të tyre nga Ministria e linjës, duke mos gjetur zbatim ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “*Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje*” dhe UMF nr. 1, datë 23.5.1995 “*Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave, të livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari*”.

21. Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, për përfundimin e procedurave për kalimin në pronësi dhe marrjen në dorëzim të pronave të pyjeve dhe kullotave.

22.Gjetje nga auditimi: Në dy raste janë lëshuar me qira pjesërisht dy vendstrehime, me një sipërfaqe prej 54 m² kontrata të lidhura sipas Kodit Civil neneve 801-825 dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, por pavarësisht se vlera e kontratës është në përputhje me çmimin e përcaktuar, referimi ligjor nuk është i plotë , pasi bazë për lidhjen e kontratave, duhet të ishte VKM nr. 280, datë 15.01.1996 “*Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse*”, të ndryshuar me VKM nr. 1001, datë 13.11.2013.

Rekomandimi:Bashkia Pogradec në lidhjen e kontratave të reja por dhe përditësimin e dy kontratave ekzistuese të mos referohet në kuadrin ligjor të përcaktuar “*Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse*”, duke u zbatuar procedurat dhe administruar i gjithë dokumentacioni.

23. Gjetje nga auditimi:Nga Bashkia Pogradec deklarohet se disponohen 22 vendstrehime në gjendje të mirë teknike, pra të përshtatshme për tu lëshuar me qira, por rezulton se nuk është bërë asnjë përpjekje për të vënë në efikasitet plotësisht apo pjesërisht këto ambiente duke krijuar mungesë të ardhurash në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore,por dhe moszbatim të VKM nr. 280, datë 15.01.1996 “*Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse*”, të ndryshuar me VKM nr. 1001, datë 13.11.2013.

Rekomandimi: Bashkia Pogradec lidhur me 22 vendstrehimet në gjendje të mirë teknike dhe të përshtatshme për tu lëshuar e dhënë me qira, nëpërmjet njoftimeve në TV, afishimeve apo çfarëdolloj forme tjetër të vlerësuar si të përshtatshme, të bëjë prezent banorëve, qytetarëve të tjerë apo dhe përdoruesve të jashtëligjshëm të tyre, mbi mundësinë e përdorimit të tyre nëpërmjet ankandit që mund të organizojë për dhënien me qira, me qëllim krijimin e të ardhurave në interes të buxhetit të njësisë vendore.

24. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi nëpunësi autorizues, nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron, apo ka në administrim Bashkia Pogradec. Po kështu, në kundërshtim me pikën 31/d të Udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira, ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, për aplikimin për regjistrim në ZVRPP Pogradec të gjitha asetëve, të kaluara në pronësi me VKM nr. 1240, datë 10.09.2008, në pronësi të Bashkisë. Të krijoj dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre e pas azhurnimit të përditësoj atë, me pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira, qofshin këto në format e trualli të lirë, apo të pajisur me infrastrukturë.

25. Gjetje nga auditimi: Nga Përgjegjësjë e sektorit të strehimit nuk ishin Inventarizuar dhe arkivuar pranë zyrës së arkivit **120 praktikat** (Dosjet) të përfituesve të kredisë me kushte lehtësuese të dhëna nga vitet 2009-2014, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Rregullorja “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”, për “Normat tekniko-profesionale-metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Rekomandimi: Sektori i Strehimit të marrë masa, për inventarizimin dhe dorëzimin në Zyrën e arkivit të Bashkisë Pogradec, dokumentacionin e 120 praktikave (Dosjeve), të përfituesve të kredisë me kushte lehtësuese, që nga momenti i dhënies së tyre.

26. Gjetje nga auditimi: Inspektori i Mjedisit pranë Bashkisë, nuk ka dërguar në zyrën e financës dhe nuk ka arkëtuar **5 gjobat** e vendosura, për shkeljet në fushën e mjedisit **në vlerën 35,000 lekë**, në kundërshtim me nenin 14 pika 2, neni 9, 22, 30 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe 44 ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

26.1. Rekomandimi: Inspektorit të Mjedisit pranë Bashkisë, të marrë masa për arkëtimin e **5 gjobave në vlerën 35,000 lekë**, në të kundërtën të zhdëmtohen nga **z. A.M.**, Inspektori i Mjedisit, i cili nuk i ka dërguar gjobat për ekzekutim në zyrën e financës dhe s’ka ndjekur arkëtimin e tyre.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

I. Mbështetur në pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën **22,778,038 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga mosllogaritja e saktë e fondit limit dhe preventivit të punimeve Operatori ekonomik fitues “**I...**”sh.p.k për kontratën date 15.07.2014, në vlerën 51,948,225 lekë me tvsh, ka përfituar padrejtësisht, duke shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të Bashkisë Pogradec në **vlerën 2,400,440 lekë** (2,330,290 + 42,800+ 27,350), të detajuara **më poshtë:**

a. Bashkia Pogradec nuk ka implementuar saktë preventivin e objektit “Sistemim rrugësh blloku lagja 1 (trekëndëshi)” Operatori ekonomik fitues “**I...**”sh.p.k për kontratën datë 15.07.2014, në Dokumentet Standarde të Tenderit (shtojcat 1 dhe 12), në kundërshtim me Projektin e Zbatimit dhe shënimet teknike (shtojca 11) për pasojë kemi një rritje artificiale të padrejtë të fondit limit, në vlerën **2,330,290 lekë** .

b. Operatori ekonomik fitues “**I...**”sh.p.k në paraqitjen e ofertës nuk ka zbatuar preventivin e projektit të zbatimit në zërin “I- Punime në rrugë”, analiza 3-210 “Shtrese çakull mbeturina kave t= 15 cm + cilindrim” me volum punimesh 12570 m², për arsye se në ofertën e paraqitur në tender ka ndryshuar njësinë e matjes nga m² në m³ ose nga sasia prej 12570 m² në sasinë prej 1832 m³, ndryshim i cili ka ulur volumin e punimeve nga 1885.50 m³ në 1832 m³ ose 53.50 m³ më pak ose në vlerën 42,800 lekë, për rrjedhojë ofertuesi është kualifikuar në kundërshtim me nenin 53 Shqyrtimi i ofertave, të LPP, të germës ç, pikës 4 -Hapja dhe vlerësimi i ofertave, kreu V Zhvillimi i procedurave, të VKM nr. 1, datë 01.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe me pikat 2, 3 dhe 9 të VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, duke shkaktuar dëm ekonomik në **vlerën 42,800 lekë** .

c- Oferta e operatorit ekonomik “**I....**”sh.p.k, nuk është hartuar në përputhje me manualin e çmimeve dhe nga krahasimi rezultuan diferenca më tepër në vlerën 27,350 lekë, pa tvsh, në kundërshtim me pikat 10 dhe 12 të VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga operatori ekonomik “Infinit” shpk në **vlerën 27,350 lekë** .

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik nga operatori ekonomik “**I...**”shpk në vlerën **2,400,440 lekë**, për rritjen artificiale të fondit limit për realizimin e objektit dhe punime të pa kryera, në tenderin me objekt “Sistemim rrugësh blloku lagja 1 (trekëndëshi)”, kontrata datë 15.07.2014.

2. Gjetje nga auditimi: Nga mos llogaritja e saktë e fondit limit, mos zbatimin e punimeve të preventivit ofertës dhe kontratës së pastrimit të qytetit Pogradec për periudhën 5 vjeçare 2009-2014, dhe diferenca tepër në afatet, frekuencat e shërbimit dhe volumet e zërave të punimeve në preventivin e shërbimit para vitit 2014, janë përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “**Paster**”, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë Pogradec një dëm ekonomik në **vlerën 5,384,469 lekë**, (4,440,501+943,968), **si më poshtë:**

I-Nga mosllogaritja e saktë e fondit limit dhe preventivit të punimeve Operatori ekonomik fitues “**P...r**”shpk, për periudhën 5 vjeçare 2009-2014, ka përfituar padrejtësisht duke shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të Bashkisë Pogradec në vlerën **4,440,501 lekë**, të detajuara **më poshtë:**

a. Preventivi i shërbimeve të pastrimit i paraqitur për vitin 2014, nuk është bazuar në kontratën datë 21.12.2008, e ndryshuar me shtesën datë 21.08.2009, me afat 5 vjeçar, në zërat e punimeve “Ngarkim, transport mbeturina familjare”, “Ngarkim, transport të ngurtash”, Lagje rrugësh (3 here/dite) dhe “Dezinfektimi i pikave të kontejnerëve”, për arsye se, është preventivuar më tepër se sasia maksimale e përcaktuar në kontratën bazë, duke shkaktuar një dëm ekonomik në **vlerën 488,029 lekë**, i përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “**P...r**”shpk .

b. Nga krahasimi i preventivit të viteve 2013, 2014 me preventivin bashkëlidhur kontratës datë 16.01.2015, me afat 5 vjeçar ose 2015-2019, u konstatuan diferenca tepër në afatet, frekuencat e shërbimit dhe volumet e zërave të punimeve në preventivin e shërbimit para vitit 2014. Diferencat më tepër rezultojnë, nga ndryshimi i volumeve në 5 zërat e punimeve të shërbimit në **vlerën 3,262,710 lekë** dhe nga ndryshimi i afatit të shërbimit në 4 zëra në vlerën 689,762 lekë ose në total **vlera 3,952,472 lekë**, e cila është përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “**P...r**”shpk, si rrjedhojë e rritjes së paargumentuara të volumit të shërbimit në preventivin e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me

germën c, pikën 2, kreu III, të VKM nr. 1, datë 10.01.2010 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar .

II-Nga operatori ekonomik “P.....r” shpk,i cili ka zbatuar tenderin e pastrimit të qytetit të Pogradecit për periudhën 2009-2014 sipas kontratës datë 22.12.2008, e ndryshuar, me afat deri më 21.03.2014, ka përfituar padrejtësisht vlerën 943,968 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Pogradec e detajuar si më poshtë:

a. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga mbikëqyrësi i kontratës, rezulton se llogaritja e ndalesave mujore, nga rillogaritja e pagesave për të gjitha volumet e pakryera për vitet 2013 dhe 2014, rezulton se nuk janë kryer ndalesat, për pasojë është shkaktuar një dëm ekonomik për **vlerën 104,187 lekë** .

b. Në 6 raste i është paguar më tepër në vlerën prej **377,545 lekë**, operatori zbatues “P.....r”shpk, duke shkaktuar një dëm ekonomik, kjo ka ardhur nga situacionimi më tepër se sasia maksimale e përcaktuar në kontratën bazë.

c-Nga mbikëqyrja e vend depozitimit të mbetjeve në Komunën Buçimas, rezultoi se nuk realizohej zëri shtyrje, sistemim dhe mbulimi me dhe i mbeturinave në fushën e grumbullimit, sipas kërkesave të kontratës datë 22.12.2008,(ndryshuar me kontratë shtesë), për pasojë operatori ekonomik. “P.....r”, ka përfituar padrejtësisht në vit vlerën prej **462,236 lekë** .

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, duke rivlerësuar pagesat e shërbimit të pastrimit për proceset e pastrimit të trajtuar nga grupi i auditimit në lidhje me operatorin ekonomik “Paster” gjithsej në vlerën **5,384,469 lekë**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga matja në fakt e distancës të vend depozitimit të plehrave të Qytetit Pogradecit, krahasuar me distancën e parashikuar në analizën e çmimit të preventivit të ofertës fituese, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomik “R.&Sh..” në harkun kohor 5 vjeçar(2015-2019), gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, mund të përfitojë padrejtësisht për zërin e punimeve të shërbimit “Ngarkim -transport mbeturina inerte në qytet” të parashikuar në preventiv **në vlerën 2,108,862 lekë**, e cila do të jetë pagesë e tepërt(pa argumentuar) për buxhetin e Bashkisë Pogradec, në kundërshtim me kushtet e kontratës të përcaktuara në DST, shtojca 7.

Rekomandimi: Bashkia Pogradec nëpërmjet një amendamenti shtesë të nënshkruar nga të dy palët të rivlerësojë e rillogarisë, vlerën e kontratës të lidhur me datë 16.01.2015 për harkun kohor 5 vjeçar(2015-2019), me operatorin fitues “R.&Sh..”, për vlerën **2,108,862 lekë**, pa tvsh, pasi kjo bie në kundërshtim me kushtet e kontratës të përcaktuara në DST, shtojca 7.

4.Gjetjet nga auditimi: Për periudhën 2 vjeçare 2013-2014, nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë, Pogradec ishin vendosur 25 gjoba në vlerën **14,294,959 lekë**, prej tyre, ishin arkëtuar nga 7 subjekte vlere prej 1,094,959 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar më datën 06.03.2015 edhe vlere e gjobave prej 13.200,000 lekë.

Për mos ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës gjobave për shumën 13,200,000 lekë, është vepruar në kundërshtim me nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenit 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime.

Bazuar në dispozitat ligjore të mësipërme nga grupi i auditimit të KLSH,u llogaritën kamat vonesat në masën 60% mbi vlerën e gjobës së pa likuiduar deri më datën 28.02.2015 **në vlerën 8,157,558 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Pogradec, respektivisht 3 vendime gjobash për subjektin “Gedi” në vlerën 7,200,000 lekë, të cilat janë në proces gjyqësor dhe 18 subjekte në vlerën 957,558 lekë.** Për këto, me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH, me shkresat nr. 211-219 datë 24.02.2015, është bërë kërkesë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Pogradec për nxjerrjen e urdhër ekzekutimeve .

Rekomandimi: Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të Bashkisë Pogradec, të marrin masa dhe të dërgojnë zyrtarisht listat e gjobave në zyrën e financës . Kjo të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin vlerës gjobave dhe kamat vonesave nga 20 subjekte në shumën **21,357,558 lekë**, e cila përbëhet nga vlere e gjobave prej **13.200,000 lekë** dhe vlere **8,157,558**

lekë, kamat vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit të KLSH, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pogradec

5. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e audituar 2013-2014 për ndërtime pa lejë apo shkelje të kushteve të lejes, me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor, **prej 1008 m2**, të konstatuara nga ana e INUV Pogradec, ndaj 4 subjekteve kundërvajtës janë vendosur gjoba minimale nga 100,000-300,000 lekë, ose gjithsej në vlerën 735,913 lekë. Ndërkohë, vlefata e punimeve është mbi shumën 5 milion lekë, gjoba duhej të vendosej bazuar në pikat 7 dhe 8 -Shkelje e kushteve të lejes dhe ndërtime pa lejë, të ligjit nr. 10119, dt. 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar. Pra masa e gjobës duhet të vendoseshin edhe në shumën **4,123,979 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Rekomandimi: IMTV Pogradec të rivlerësojë vendimet për masën e gjobës në zbatim të përcaktimeve të bëra në pikën 7-Shkelje e kushteve të lejes dhe **pikën 8-** Kryerja e punimeve pa leje dhe me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, duke kërkuar në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ndaj 4 subjekteve në vlerën **4,123,979 lekë**,

Nr	Subjekti	Vendimi KRRT Pogradec Nr, datë	Vendimi i gjobës të INUV Pogardec Nr datë	Shtesa e sipërfaqes dhe vlera e Preventivit					Masa e Gjobës vendosur nga INUVI	Diferenca Që duhet të ngarkohet, sipas KLSH
				Sip M2	Kosto Entit Komb Banes	Vlera e Preventi	Mas Gj ob Në %	Vlera gjobës që duhet të paguajë		
a	b	c	d	1	2	3	4	5	6	7
1	“3 P....t” shpk	53/28.2.2010	21/9.6.2014	514,7	31,910	16,424,677	20	3,284,815	100,000	3,184,815
2	“L....or”		18/19.11.13	159	31,910	5,073,690	10	507,369	300,000	207,369
3	“N..i”shpk		6/3.6.2013	164.6	31,910	5,252,386	10	525,238	235,913	289,325
4	J.T		17/18.10.13	170	31,910	5,424,700	10	542,470	100,000	442,470
	SHUMA			1008		32,165,280		4,859,892	735,913	4,123,979

6- Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Blerje kuote ushqimore për çerdhen e qytetit”nga verifikimi i faturave tatimore rezultoi se subjekti fitues “R.D” ka përfituar padrejtësisht vlerën e TVSH në shumën **133,987 lekë e cila përbën dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë Pogradec, pasi nuk është subjekt i regjistrimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Aneksi 5, kategoria II dhe VKM Nr. 1058, datë 21.10.2009, “Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)”, i ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Pogradec të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik nga subjekti “R.D” në vlerën **133,987 lekë**.

7-Gjetje nga auditimi: Çmimi i karburantit të furnizuar nga firma fituese “K...” Sh.p.k është më i lartë se çmimi i karburantit i llogaritur sipas çmimit të bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave. Faturat nuk janë shoqëruar me dokumente justifikuese për ndryshimin çmimin si deklarata doganore SAD. Këto veprime bien në kundërshtim me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit, pika “Çmimi i kontratës”, Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave si dhe kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreut VIII, pika 2- Mbikëqyrja e kontratës, shkronja “c”, për pasojë **subjekti “K...” Shpk**, ka përfituar padrejtësisht **shumën 65,619 lekë** në total, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Rekomandim: Bashkia Pogradec të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik ndaj operatorit ekonomik “K..” Sh p k., në vlerën **65,619 lekë**.

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “*Blerje lëndë djegëse(dru zjarri) viti 2013*” është preventivuar padrejtësisht zëri “*Përdorimi i 3 sobave të zjarrit me dy turne tek Çerdhja e qytetit*”, pasi orari normal i ofrimit të shërbimit në çerdhen e qytetit është nga ora 08.00 deri në 16.00, i njëjti me kopshtet e tjera që funksionojnë deri në orën 16.00, për të cilat përdorimi druve të zjarrit për sobat është preventivuar për një turn. Për pasojë përfshirja në preventiv e këtij zëri **në vlerë 43.200 lekë**, është i paargumentuar dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Rekomandim: Duke qenë se për këtë procedurë prokurimi, nuk është kryer asnjë likuidim ndaj operatorit “A.. co” Sh.p.k, nga shuma totale prej 774,000 lekë, që ka detyrimin për likuidim, nga ana e Zyrës së Financës të mos likuidohet **shuma 43,200 lekë**.

9. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec në cilësinë e qiradhënësit dhe L.T në cilësinë e Qiramarrësit me objekt “*Ambiente te Markatoja e Qytetit*”, si rezultat i moszbatimit të shlyerjes së pagesës dhe mos aplikimit të kushtit penal është krijuar një e ardhur e munguar në vlerën prej **40,700 lekë**. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014 dhe nenit 7 “Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit” të kontratës së qiradhënies .

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të kërkojë në rrugë ligjore, shpërblimin e dëmit ekonomik Personit fizik L.T në vlerën **40,700 lekë**.

10. Gjetje nga auditimi: Në kontratën e qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Tirana Bank, me objekt “*Vendosje Bankomati*”, nuk ka përcaktuar detyrimin e qiramarrësit, për lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike të Bankomatit me “ÇEZ” sha, sot “OSHEE” sha, ku sipas përlllogaritjeve të bërë rezulton se i është shkaktuar buxhetit të Bashkisë Pogradec një dëm ekonomik për vlerën **16,632 lekë** .

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit ekonomik subjektit “*T.... B..*” në vlerën **16,632 lekë**.

11. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “*Bojra Printeri*”, me fitues subjektin “*I.P*”, u konstatua **dëm ekonomik në vlerën 27,500 lekë** pasi nga verifikimi i faturës tatimore rezultoi se vlera e mallrave të furnizuar pa TVSh, nga operatori nuk është e njëjtë me vlerën e ofertës për të cilën është shpallur fitues në sistem për të njëjtën sasi malli .

Rekomandim: Duke qenë se për këtë procedurë prokurimi është likuiduar shuma 63,000 lekë ndaj operatorit “*I.P*”, nga shuma totale prej 165,000 lekë që ka detyrimin për këtë operator ekonomik, nga ana e Zyrës së Financës të mos likuidohet shuma **27,500 lekë**.

12. Gjetje nga auditimi: Nga mosllogaritja e kostos së ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave dhe Preventivit të paraqitur nga 2 Subjekte ndërtues është krijuar një e ardhur e munguar një për Buxhetin e Bashkisë Pogradec në vlerën **275,092 lekë**, konkretisht:

a. Për objektin “*Banesë 3 kat + dyqan + podrum*”, me leje ndërtimi nr. 43, datë 11.10.2005, nr. 55, datë 11.10.2006, me subjekt ndërtues “*A...*” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi më datë 09.02.2013, ku si pasojë e mosllogaritjes të diferencës ndërmjet kostos sipas EKB dhe preventivit, subjektit nuk i është përlllogaritur detyrimi shtesë për të paguar në vlerën **prej 164,381 lekë**.

b. Për objektin “*Ambiente shërbimi + banimi 6-8 kat + 1 kat nën tokë*”, me leje ndërtimi nr. 53, datë 28.02.2010, me subjekt ndërtues “*T..P....*” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi më datë 19.06.2013, ku si pasojë e mosllogaritjes të diferencës ndërmjet kostos sipas EKB dhe preventivit, subjektit nuk i është përlllogaritur detyrimi shtesë për të paguar në vlerën prej **110,711 lekë**.

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimin e dëmit, nga 2 subjekte ndërtuese në vlerën **275,092 lekë, respektivisht;**

-nga subjekti ndërtues “*A..*” sh.p.k. për objektin “*Banesë 3 kat + dyqan + podrum*”, Zona Kadastrale 8582, në vlerën **164,381 lekë**.

- nga subjekti ndërtues “*T.. P...*” sh.p.k. për objektin “*Ambjente shërbimi + banimi 6-8 kat + 1 kat nën tokë*”, Zona Kadastrale 8581, në vlerën **110,711 lekë**.

Në ndërmarrjet e vartësisë.

1.Në Qendrën Kulturore-LasqushPoradeci.

13.Gjetje nga auditimi: Në transaksionin nr. 41 /1, datë 27.05.2013, në vlerën 9800 lekë me objekt shpenzimi “Blerje llamba porcelani”, fatura tatimore e shitjes nr. 39, date 21.05.2013, nuk është bazuar në praktikën e blerjes, për arsye se, komisioni i prokurimeve ka vendosur të përcaktojë fitues **Personin Fizik z. I.K** në vlerën 5500 lekë për artikujt llamba ekonomike 10 copë, prozhektor 2 copë dhe priza dhe jo vlerën 9,800 lekë, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **4,300 lekë**.

Rekomandim:Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i **dëmit ekonomik në vlerën 4,300 lekë**, ndaj operatorit ekonomik “I.K”, sa është paguar padrejtësisht, si rezultat i ndryshimit të çmimet për njësi të artikujve, në kundërshtim me praktikën e blerjes sipas Urdhër Prokurimit nr, 16, datë 23.05.2013, procesverbalin e prokurimeve me vlerë të vogël datë 24.05.2014.

2.Në Sektorin Mbështetës të Arsimit.

14.Gjetje nga auditimi: Në 6 transaksione me objekt shpenzimi “Blerje Ushqimesh Çerdhe”, operatori ekonomik “R.D”, ka ndryshuar çmimet e mallrave, në kundërshtim me kontratat datë 06.05.2014 dhe 01.07.2014, sepse mbi çmimin për njësi është aplikuar tvsh, duke shkaktuar dëm ekonomik **në vlerën 75,815 lekë**.

Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i **dëmit ekonomik në vlerën 75,815 lekë**, ndaj operatorit ekonomik “R.D”, sa është paguar padrejtësisht, si rezultat i ndryshimit të çmimet për njësi të artikujve, në kundërshtim me kontratat datë 06.05.2014 dhe 01.07.2014, sepse mbi çmimin për njësi është aplikuar tvsh, ndërkohë që subjekti nuk ka lëshuar faturë tatimore shitje.

3.Në Klubin Shumë Sportësh

15. Gjetje nga auditimi: Operatori ekonomik ka ndryshuar çmimet e mallrave, në kundërshtim me procesverbalin nr. 6, datë 11.09.2014, të Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël, për arsye se në faturën e thjeshtë tatimore mod. 4, mbi çmimin për njësi është aplikuar tvsh, gjë që ka përfituar padrejtësisht **vlerën 32,000 lekë**.

15.1. Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i **dëmit ekonomik në vlerën 32,000 lekë**, ndaj operatorit ekonomik “B.C”, sa është paguar padrejtësisht, si rezultat i ndryshimit të çmimet për njësi të artikujve, në kundërshtim me procesverbalin nr. 6, datë 11.09.2014, të Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël.

B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE (3E):

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit “Pastrimi grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike në Qytetin e Pogradecit”, me fond limit për vlerën 199,378,000 lekë, me tvsh fitues operatori ekonomik “B.O.E Sh.. &R...”, burim i financimit nga të ardhurat e bashkisë. Kontratë me afat 5 vjeçar datë 15.01.2015 (Janar 2015-Janar 2019) -5vjet x 33,010,417 lek /vit, (pa tvsh), u konstatua se në procedurën e prokurimit, ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **4,796,530 lekë**, e llogaritur si diferencë ndërmjet ofertës së paraqitur në këtë tender të bashkimit të operatorëve ekonomik “P&K dhe bashkimi i operatorit ekonomik “R..& Sh” edhe pse ka paraqitur ofertën më të lartë në vlerën 165,052,087 lekë (pa tvsh).

Ky operator megjithëse ka paraqitur ofertën më të ulët në vlerën 160,255,557 lekë, është skualifikuar ndërsa bashkimi i operatorit ekonomik “R& Sh” edhe pse ka paraqitur ofertën më të lartë në vlerën 165,052,087 lekë, ky i fundit është shpallur fitues. Veprime këto në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën 6 faqe 126-166 -Auditimi i prokurimeve viti 2014)

Rekomandimi: Bashkia Pogradec të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike, për 4 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **4,796,530 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i rekomandojmë Komisionit disiplinor pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga shërbimi civil**”, për **13 punonjësit**, si më poshtë:

1. zj. V.B me detyrë Përgjegjëse e Kontrollit dhe Zhvillimit të DPKZHT,

2. zj. M.K me detyrë ish-Përgjegjëse e Kontrollit dhe Zhvillimit të DPKZHT, aktualisht Specialiste e nivelit të lartë për regjistrin e territorit dhe arkivën,

3. z. T.B me detyrë Specialist i Nivelit të Lartë për Inspektimin e Zhvillimit dhe Lejeve të Përdorimit i DPKZHT,

Për 3 punonjësit e cituar më sipër respektivisht nr. rendor 1-3, për shkeljet e mëposhtme:

- Për moslllogaritjen e mosrakordimin e kostos së ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave dhe Preventivit të paraqitur nga Subjekti ndërtues duke krijuar një dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Pogradec në vlerën 275,092 lekë, dhe konkretisht:

- Për objektin “*Banesë 3 kat + dyqan + podrum*”, me leje ndërtimi nr. 43, datë 11.10.2005, nr. 55, datë 11.10.2006, me subjekt ndërtues “*A..*” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi më datë 09.02.2013, ku si pasojë e moslllogaritjes të diferencës ndërmjet kostos sipas EKB dhe preventivit, subjektit nuk i është përlllogaritur detyrimi shtesë për të paguar në vlerën prej 164,381 lekë.

-Për objektin “*Ambiente shërbimi + banimi 6-8 kat + 1 kat nën tokë*”, me leje ndërtimi nr. 53, datë 28.02.2010, me subjekt ndërtues “*T.. P...*” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi më datë 19.06.2013, ku si pasojë e moslllogaritjes të diferencës ndërmjet kostos sipas EKB dhe preventivit, subjektit nuk i është përlllogaritur detyrimi shtesë për të paguar në vlerën prej 110,711 lekë.

-Për objektin “*Godinë banimi + ambiente shërbimi 7 kat + çati e shfrytëzuar + 1 kat nën tokë*”, me leje ndërtimi nr 70, datë 18.12.2010 dhe nr. 75, datë 29.08.2011, me subjekt ndërtues “*B..*” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi më datë 18.05.2014, ku ka rezultuar se nuk ekziston Studimi Sizmiologjik për zonën ku është ndërtuar objekti si dhe relacioni përkatës, pasi objekti është mbi 8 kate, ose 10 në rastin konkret, si dhe se Shoqërisë “*B...*” i mungon kategoria e licencës për realizimin e punimeve, pasi sipas licencës nr. NZ 6748, shoqëria ka kategorinë NP-2 A, për Ndërtime Civile dhe Industriale, kur duhet të kishte kategorinë C.

- Për objektin “*Banesë kolektive + ambiente shërbimi 9 kat+ 1 kat nëntokë*”, me leje ndërtimi nr. 51, datë 21.02.2009, me subjekt ndërtues “*B...*” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi me datë 09.09.2014, ku ka rezultuar se Shoqërisë “*B...*” i mungon kategoria e licencës për realizimin e punimeve pasi sipas licencës nr. N5574, shoqëria ka kategorinë 3 a,b,c, për Ndërtime Civile dhe Industriale, kur duhet të kishte kategorinë E.

- Për objektin “*Banesë kolektive + ambiente shërbimi 9 kat+ 1 kat nëntokë*”, me leje ndërtimi nr. 51, datë 21.02.2009, me subjekt ndërtues “*B...*” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi me datë 09.09.2014, objekti i ndërtuar në bashkëpunim me shoqërinë “*L...*” sh.p.k. të cilës i mungon kategoria e licencës për realizimin e punimeve pasi disponon vetëm kategorinë NP-2 A, për punime deri 20 milion, kur preventivi i objektit është 135 milion.

- Për objektin “*Pallat 1-4-7 kat + 1 kat nën tokë + çati e shfrytëzuar*”, miratuar me vendim të KRRT-së nr. 06, datë 01.09.2007, dhe nr. 10, datë 01.12.2007, me subjekt ndërtues “*O..*” sh.p.k. ku është

konstatuar se nuk ekziston Studimi Sizmiologjik për zonën ku është ndërtuar objekti, si dhe relacioni përkatës, pasi objekti është mbi 8 kate.

- Nuk ka certifikatë apo vërtetim pronësor të lëshuar nga ZVRPP Pogradec, lidhur me regjistrimin e infrastrukturës të nevojshme për funksionimin e zhvillimin e investimit i cili e lidh zhvillimin e ri me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave dhe që realizohet nga zhvilluesi. Në referim të VKM nr. 480, datë 22.6.2011, neni 10 *“Kushtet për zhvillim”*, pika 11, është përcaktuar se leja e përdorimit jepet vetëm pasi kjo infrastrukturë regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi dhe përfituesja e saj është njësia e qeverisjes vendore.

- Në 25 *raste* licencat e inxhinierëve të fushës nuk janë të njësuara me origjinalin, për më tepër nuk ka kontrata pune apo bashkëpunimi apo dhe marrëveshje ndërmjet shoqërisë zbatuese të investimit dhe personave për llojin e bashkëpunimit që do të realizojnë.

- Në 27 *raste* rezulton se në dosjen e praktikës së lejes së Ndërtimit dhe Përdorimit, mungon vërtetim nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor lidhur me pagesën e detyrimeve për gjoba apo tarifa shërbimi, si dhe nuk është mbajtur korrespondencë zyrtare ndërmjet DPKZH dhe INUV.

Veprime në kundërshtim me ligjin ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 *“Për Planifikimin e Territorit”*, i ndryshuar me ligjin nr. 10258, datë 25.03.2010, Aktin normativ nr. 4, datë 25.8.2010 (miratuar me ligjin nr. 10315, datë 16.9.2010), ligjin nr. 10360, datë 16.12.2010, ligjin nr. 22/2013 dhe ligji nr. 110/2013, datë 01.04.2013, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 *“Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit”* e ndryshuar me VKM nr. 88, datë 07.02.2012, VKM nr. 139, datë 22.02.2012, VKM nr. 345, datë 09.05.2012 dhe VKM nr. 314, datë 13.3.2013, ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 *“Për inspektimin e ndërtimit”* dhe ligjin nr. 8420, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*.

4.zj. E.L me detyrë Përgjegjëse e sektorit të buxhetit, thesarit pagave dhe arkën, për arsye se:

-Mungojnë dokumentet bashkëlidhur urdhër-shpenzimeve faturë tatimore shitje, situacion, procesverbale mbi kontrollin e punës dhe pagesat (monitorimi kontratës), në kundërshtim me nenin 6 Evidenca mbështetëse, pika 1, e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*.

- Ka lejuar likuidim me vonesë të faturave, në kundërshtim me udhëzimin e M.F. nr.2 datë 06. 02. 2012 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, i ndryshuar.

-Për mos kontabilizimin, mos ndjekjen e procedurave të arkëtimit dhe mos fillimin e ndalesave të debitorëve.

-në cilësinë e anëtarit të komisionin e verifikimit të sipërfaqeve të rrugëve dhe hartimin e preventivit,pasi:

-Nuk ka argumentuar volumet e shërbimit të pastrimit të qytetit të Pogradecit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2010 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar , kreu III, pika 2, germa “c”,pasi nuk janë bazuar në kontratën datë 22.12.2008, e ndryshuar, për rrjedhojë janë rritur në mënyrë të paargumentuara volumit e shërbimit në vlerën 282,223 lekë.

-Nuk ka argumentuar ndryshimet në volume, afate, frekuencat në zërat e shërbimeve për vlerën 2,374,169 lekë.

5.zj. I.LI me detyrë Përgjegjësja e Sektorit të Strehimit.

-Ka tejkaluar kompetencat, duke marrë përsipër detyrat e komisionit të strehimit, pa u kaluar 13 praktika në komisionin e strehimit.

-Në mungesë të krijimit të komisionit të strehimit dhe kalimi i 13 praktikave të personave që kanë përfituar strehim në vitet 2013-2014,në kundërshtim me VKM nr. 574, datë 29.08.2012 Pikë 7, ku përcaktohet se: Komisioni i strehimit, sa herë që në njësinë vendore zbatohet projektet-strehimi, sipas ligjit nr. 9232,datë 13.05.2004, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin brenda 10 ditëve nga data e marjes në dorëzim të tij nga zyra përkatëse e njësisë së qeverisjes vendore dhe vendos pikët për secilin aplikues.

-Nuk ka inventarizuar dokumentacionin që përmbante dosja e përfituesve të kredisë, të cilët ishin miratuar në Këshillin Bashkiak,në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 *“Për Arkivat”*.

Rregullorja “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”, Për “Normat tekniko-profesionale-metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” dhe Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

6.z.V.Xh me detyrë Specialist për inspektimin e zhvillimin dhe kadastrës urbane, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, në cilësinë e anëtarit të komisionin e verifikimit të sipërfaqeve të rrugëve dhe hartimin e preventivit,

7.z. Dh.Gj, me detyrë Përgjegjës Sektori i Planifikimit të Territorit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, në cilësinë e anëtarit të komisionin e verifikimit të sipërfaqeve të rrugëve dhe hartimin e preventivit.

Për arsye se 2 punonjësit e cituar më sipër me numër rendor 6-7 :

-Nuk kanë argumentuar volumet e shërbimit të pastrimit të qytetit të Pogradecit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2010 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik:, i ndryshuar , kreu III, pika 2, germa “c”, pasi nuk janë bazuar në kontratën datë 22.12.2008, e ndryshuar, për rrjedhojë janë rritur në mënyrë të paargumentuara volumit e shërbimit në vlerën **282,223 lekë**.

-Nuk kanë argumentuar ndryshimet në volume, afate, frekuencat në zërat e shërbimeve për vlerën 2,374,169 lekë.

8. F.B, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit të Aseteve, Statistikës dhe Promocionit, **për shkeljet e mëposhtme:**

-Për gjithë aktivet që zotëron apo ka në administrim Bashkia nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohej sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik. Në kundërshtim me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për mos ndjekjen e pagesës të qerasë të ambientit Merkatoja e Qyteti, sipas kontratës datë 10.12.2012, me pasojë mos arkëtimi në kohë dhe mos llogaritje penalitetesh nga subjekti Lefter Tanellari të vlerës qerasë prej 29,000 lekë. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014.

-Nuk është miratuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe nuk është kërkuar në ZVRPP Pogradec të kryhet regjistrimi i truallit dhe objektit, për Kontratën e datës 30.03.2004 me numër rep. 22 lidhur me “Ble-Alb”, objekti i dhënë me qira është pjesë e pasurisë nr. 9/107 e regjistruar në vol. 19, faqe 180, zona kadastrave 8581, nga ku trualli është 2867 m² dhe objekti po 2867 m², dhe sipas librit të ngastrave është me pronar shtet, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

-Nuk ka argumentuar volumet e shërbimit të pastrimit të qytetit të Pogradecit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2010 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik:, i ndryshuar , kreu III, pika 2, germa “c”,pasi nuk janë bazuar në kontratën datë 22.12.2008, e ndryshuar, për rrjedhojë janë rritur në mënyrë të paargumentuara volumit e shërbimit në vlerën **282,223 lekë**.

-Nuk kanë argumentuar ndryshimet në volume, afate, frekuencat në zërat e shërbimeve për vlerën 2,374,169 lekë.

9. z. P.K, me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të taksave dhe tarifave vendore për një periudhë 9 mujore nga data 01.03.2014 e ne vazhdim dhe

10. znj.A.H, me detyrë specialiste në Sektorin e taksave, **për shkeljet e mëposhtme:**

-Nuk kanë dërguar në zyrën e financës në fund të vitit 2013-2014 listën me debitorët e taksave vendore për vlerën 3.637.900 lekë, përkatësisht, për taksën e biznesit te madh në vlerën 1.424.475 lekë dhe për biznesin e vogël në vlerën 2.213.425 lekë.

-Për mos planifikim të saktë të taksave të popullatës.

-Nuk kanë marë masa për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore, duke mos u dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

-Nuk i kanë dërguar Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e bares siguruese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë". i ndryshuar.

11. **zj. R.S** me detyrë Drejtore e Ekonomisë dhe Turizmit,

12. **z A.D** me detyrë Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Turizmit dhe për administrimin e aseteve dhe statistikave, *për shkeljet e mëposhtme:*

-Për gjithë aktivet që zotëron apo ka në administrim Bashkia nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohej sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik. Në kundërshtim me Kapitullin III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Për mos ndjekjen e pagesës të qerasë të ambientit Merkatoja e Qyteti, sipas kontratës datë 10.12.2012, me pasojë mos arkëtimi në kohë dhe mos llogaritje penalitetesh nga subjekti Lifter Tanellari të vlerës qerasë prej 29,000 lekë. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", si dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014.

-Nuk është miratuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe nuk është kërkuar në ZVRPP Pogradec të kryhet regjistrimi i truallit dhe objektit, për Kontratën e datës 30.03.2004 me numër rep. 22 lidhur me "B...", objekti i dhënë me qira është pjesë e pasurisë nr. 9/107 e regjistruar në vol. 19, faqe 180, zona kadastrave 8581, nga ku trualli është 2867 m² dhe objekti po 2867 m², dhe sipas librit të ngastrave është me pronar shtet, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit".

13.**z.E.M**, Administrator i kontratës,së pastrimit.

-Nga mungesa e kontrollit periodik të zbatimit të kontratës të pastrimit qytetit, shpenzime të cilat zënë një peshë të konsiderueshme në shpenzimet e buxhetit bashkisë me pasojë shkaktimin e një dëm ekonomik buxhetit të bashkisë Pogradec në **vlerën 2,594,594 lekë**.

II. *Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë titullarit të Njesisë Publike, Kryetarit të Bashkisë Pogradec , fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje" deri në "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", për 15 punonjësit e mëposhtëm:*

1.**z.D.H**,me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit dhe njëherazi Nënkyetar i Bashkisë, **për shkeljet e mëposhtme:**

-Ka lejuar kryerjen e pagesave për 2 punonjës, pa u pajisur me dokumentin e njehsimit të Diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

-Nuk ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve të vendimit nr. 679, datë 20.11.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës parë Korçë dhe dërgimin me shumë vonesë të padive për shpërblim dëmi në organet Gjyqësore,

-Për veprimet e largimit të pa motivuar nga puna të 6 punonjësve, në kundërshtim me nenet 143,144,145,146,153,155 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe nenet 126 , 306-310 të Kodit të Procedurës Civile, duke shkaktuar një impakt negativ financiar në buxhetin e Bashkisë Pogradec në vlerën **3,947,160 lekë**.

-Për gjithë aktivet që zotëron apo ka në administrim Bashkia nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohej sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe

data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik. Në kundërshtim me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për mos ndjekjen e pagesës të qerasë të ambientit Merkatoja e Qyteti, sipas kontratës datë 10.12.2012, me pasojë mos arkëtimi në kohë dhe mos llogaritje penalitetesh nga subjekti Lefter Tanellari të vlerës qerasë prej 29,000 lekë. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014.

-Nuk është miratuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe nuk është kërkuar në ZVRPP Pogradec të kryhet regjistrimi i truallit dhe objektit, për Kontratën e datës 30.03.2004 me numër rep. 22 lidhur me “B”, objekti i dhënë me qira është pjesë e pasurisë nr. 9/107 e regjistruar në vol. 19, faqe 180, zona kadastrave 8581, nga ku trualli është 2867 m² dhe objekti po 2867 m², dhe sipas librit të ngastrave është me pronar shtet, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” .

2. z. P.Z me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, dhe njëherazi Nënkryetar i Bashkisë, **për shkeljet e mëposhtme:**

- Për mosllogaritjen e mosrakordimin e kostos së ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave dhe Preventivit të paraqitur nga Subjekti ndërtues duke krijuar një dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, i cili shkon në vlerën 275,092 lekë, dhe konkretisht:

- Për objektin “Banesë 3 kat + dyqan + podrum”, me leje ndërtimi nr. 43, datë 11.10.2005, nr. 55, datë 11.10.2006, me subjekt ndërtues “A..a” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi më datë 09.02.2013, ku si pasojë e mosllogaritjes të diferencës ndërmjet kostos sipas EKB dhe preventivit, subjektit nuk i është përlllogaritur detyrimi shtesë për të paguar në vlerën prej 164,381 lekë.

-Për objektin “Ambiente shërbimi + banimi 6-8 kat + 1 kat nën tokë”, me leje ndërtimi nr. 53, datë 28.02.2010, me subjekt ndërtues “T..P” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi më datë 19.06.2013, ku si pasojë e mosllogaritjes të diferencës ndërmjet kostos sipas EKB dhe preventivit, subjektit nuk i është përlllogaritur detyrimi shtesë për të paguar në vlerën prej 110,711 lekë.

-Për objektin “Godinë banimi + ambiente shërbimi 7 kat + çati e shfrytëzuar + 1 kat nën tokë”, me leje ndërtimi nr 70, datë 18.12.2010 dhe nr. 75, datë 29.08.2011, me subjekt ndërtues “B” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi më datë 18.05.2014, ku ka rezultuar se nuk ekziston Studimi Sizmiologjik për zonën ku është ndërtuar objekti si dhe relacioni përkatës, pasi objekti është mbi 8 kate, ose 10 në rastin konkret, si dhe se Shoqërisë “B” i mungon kategoria e licencës për realizimin e punimeve, pasi sipas licencës nr. NZ 6748, shoqëria ka kategorinë NP-2 A, për Ndërtime Civile dhe Industriale, kur duhet të kishte kategorinë C.

- Për objektin “Banesë kolektive + ambiente shërbimi 9 kat+ 1 kat nëntokë”, me leje ndërtimi nr. 51, datë 21.02.2009, me subjekt ndërtues “B” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi me datë 09.09.2014, ku ka rezultuar se Shoqërisë “B” i mungon kategoria e licencës për realizimin e punimeve pasi sipas licencës nr. N5574, shoqëria ka kategorinë 3 a,b,c, për Ndërtime Civile dhe Industriale, kur duhet të kishte kategorinë E.

- Për objektin “Banesë kolektive + ambiente shërbimi 9 kat+ 1 kat nëntokë”, me leje ndërtimi nr. 51, datë 21.02.2009, me subjekt ndërtues “B” sh.p.k. për të cilin është lëshuar leje përdorimi me datë 09.09.2014, objekti i ndërtuar në bashkëpunim me shoqërinë “L” sh.p.k. të cilës i mungon kategoria e licencës për realizimin e punimeve pasi disponon vetëm kategorinë NP-2 A, për punime deri 20 milion, kur preventivi i objektit është 135 milion.

- Për objektin “Pallat 1-4-7 kat + 1 kat nën tokë + çati e shfrytëzuar”, miratuar me vendim të KRRT-së nr. 06, datë 01.09.2007, dhe nr. 10, datë 01.12.2007, me subjekt ndërtues “O” sh.p.k. ku është konstatuar se nuk ekziston Studimi Sizmiologjik për zonën ku është ndërtuar objekti, si dhe relacioni përkatës, pasi objekti është mbi 8 kate.

- Nuk ka certifikatë apo vërtetim pronësor të lëshuar nga ZVRPP Pogradec, lidhur me regjistrimin e infrastrukturës të nevojshme për funksionimin e zhvillimin e investimit i cili e lidh zhvillimin e ri me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave dhe që realizohet nga zhvilluesi. Në referim të VKM nr. 480, datë 22.6.2011, neni 10 *“Kushtet për zhvillim”*, pika 11, është përcaktuar se leja e përdorimit jepet vetëm pasi kjo infrastrukturë regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi dhe përfituesja e saj është njësia e qeverisjes vendore.

- Në 25 raste licencat e inxhinierëve të fushës nuk janë të njësuara me origjinalin, për më tepër nuk ka kontrata pune apo bashkëpunimi apo dhe marrëveshje ndërmjet shoqërisë zbatuese të investimit dhe personave për llojin e bashkëpunimit që do të realizojnë.

- Në 27 raste rezulton se në dosjen e praktikës së lejes së Ndërtimit dhe Përdorimit, mungon vërtetim nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor lidhur me pagesën e detyrimeve për gjoba apo tarifa shërbimi, si dhe nuk është mbajtur korrespondencë zyrtare ndërmjet DPKZH dhe INUV.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 *“Për Planifikimin e Territorit”*, i ndryshuar me ligjin nr. 10258, datë 25.03.2010, Aktin normativ nr. 4, datë 25.8.2010 (miratuar me ligjin nr. 10315, datë 16.9.2010), ligjin nr. 10360, datë 16.12.2010, ligjin nr. 22/2013 dhe ligji nr. 110/2013, datë 01.04.2013, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 *“Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit”* e ndryshuar me VKM nr. 88, datë 07.02.2012, VKM nr. 139, datë 22.02.2012, VKM nr. 345, datë 09.05.2012 dhe VKM nr. 314, datë 13.3.2013, ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 *“Për inspektimin e ndërtimit”* dhe ligjin nr. 8420, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*.

3. z.**K.Gj**, Kryeinspektori i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor Pogradec.

4. z.**A.M**, Inspektor në IMTV

5. z.**G.Sh**, Inspektor në IMTV

6. z.**R.K**, Inspektor në IMTV

Për personat me numër rendor 3-6 për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk është mbajtur regjistër dhe një praktikë protokollimi të akteve të nxjerra gjatë veprimtarisë së INUV-it dhe të ankimeve, në kundërshtim me nenin 81 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 *“Për Planifikimin e Territorit”* pika 4 u përcaktohet se: Aktet e nxjerra nga autoritetet e inspektimit gjatë veprimtarisë së tyre ose të ankimit botohen në regjistër e sipas mjeteve tradicionale të informimit.

-Vendimet për dënim me gjobë nuk janë trajtuar si letra me vlerë, nuk janë dërguar zyrtarisht në zyrën e financës, nuk është bërë shoqërimi i dorëzimit të tyre me proces verbal nga një punonjës tek tjetri, në kundërshtim me VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 për *“Shtypjen e letrave me vlerë”* i ndryshuar me VKM nr. 277, dt. 6.4.2011 dhe VKM nr. 393 datë 18.06.2014 pika 2

-Për mos nisjen e procedurave për arkëtimin e 7 gjobave në vlerën 14,160,000 lekë respektivisht vlerën e 7 gjobave për 2,600,000 lekë dhe kamat vonesat për vlerën 1,560,000 lekë.

-Nga 16 kundërvajtës nuk ishin paguar gjobat e vendosura në mënyrë vullnetare brenda afatit ligjor prej 5 ditësh, ndërkohë nga ana e INUV Pogradec nuk ishin llogaritur kamat vonesat eaktuara në masën 2% deri 30 ditë dhe duhet të ngarkohen me kamat vonesë mbi vlerën e gjobës për 8,157,558 lekë, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”*, me ndryshime.

-Ndaj 5 subjekteve të cilët kishin përfunduar objektet dhe më vonë pa u pajisur me lejë zhvillimi, kishin vazhduar punimet duke përfutur sipërfaqe shtesë, për të cilat nga INUV Pogradec ishin dënuar me gjobë nga 100,000-300,000 lekë. Ndërkohë duke qenë se vlefte e preventivit kalonte shumë mbi 5 milion lekë, duhet të dënoheshin në masën 10-20% të vlerës së preventivit. Për pasojë 4 subjekteve nuk u ishte kërkuar shembja e objektit për sipërfaqen shtesë, por ishte mjaftuar vetëm me vendosjen e gjobës minimale edhe pse kanë përfutur një sipërfaqe prej 1008 m² dhe duhet të dënoheshin edhe për vlerën **4,123,979** lekë.

-Në 21 procesverbale kontrolli dhe konstatimi dhe 14 proces për pezullimet e punimeve mbi bazën e të cilave ka dalë vendimi i prishjes objekteve, apo vendimet për gjoba nuk është vendosur referenca

ligjore e llojit të kundërvajtjes, në kundërshtim me VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor” (Ndryshuar me vendim të KM nr. 625, datë 28.7.2010), pikën

-Nga ana e INUV Pogradec nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të Bashkisë Pogradec, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar neni 81-Inspektimi, pika 3 duke mos njohur gjendjen dhe mos kontrolluar plotësimin e kushteve dhe dokumentacionit, pasi prej kësaj të fundit për periudhën 2 vjeçare 2013-2014 janë dhënë 29 leje përdorimi.

Për 8 punonjësit e Policisë Bashkiake,

7.V.H, me detyrë Inspektor nga data 22.04.2005 dhe në vazhdim,

8.A.H, me detyrë polic bashkiak nga data 23.06.2005 dhe në vazhdim,

9.A.J, me detyrë polic bashkiak nga data 18.03.2014 dhe në vazhdim,

10.A.B, me detyrë polic bashkiak nga data 16.04.2005 dhe në vazhdim,

11.A.Y, me detyrë polic bashkiak nga data 16.04.2010 dhe në vazhdim,

12.A.M, me detyrë polic bashkiak nga data 01.07.2013 dhe në vazhdim,

13.A.T, me detyrë polic bashkiak nga data 23.06.2005 - në vazhdim,

14.J.Th, me detyrë polic bashkiak nga data 11.05.2005- në vazhdim,

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos administrimin e blloqeve të gjobave të Policisë Bashkiake në përputhje me kërkesat e VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 për “Shtypjen e letrave me vlerë” i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 6.4.2011 dhe VKM nr.393 datë 18.06.2014 pika 2.

-Nuk kanë kryer detyrat pasi nuk kanë vendosur gjoba kur llojet e kundërvajtjeve janë të shumta dhe prezente, duke mos zbatuar nenin 13 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, “Për policinë bashkiake e të komunës”, të ndryshuar dhe nenin 8 të Rregullores Brendshme “TIP” të Policisë Bashkiake e të Komunës të miratuar me Urdhrin e përbashkët të Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrisë të Rendit, nr. 1 datë 17.04.2003, Kreu V “Detyrat dhe të drejtat”.

-Për mos nisjen e procedurave ligjore për ekzekutimin e gjobave deri në datë 31.12.2014, dhe mos regjistrimin e tyre në kontabilitet, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 14 pika 2 si dhe të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 44-“Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”.

Për z.V.H, me detyrë Inspektor nga data 22.04.2005-në vazhdim edhe për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos bashkëpunim dhe punë pa përgjegjësi të Policisë Bashkiake me Sektorine Tatim Taksave në drejtim të evdientimit të subjekteve debitore dhe subjekteve të paregjistruara duke mos respektuar kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Për mos ekzekutimin e urdhrave të kryetarit të bashkisë për arkëtimin e taksave në kundërshtim me ligjin nr.8224 datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës” ndryshuar me ligjin nr.8335, datë 23.4.1998 dhe konkretisht në nenin 8, detyrat e Policisë Bashkisë pika 3 përcaktohet se: Të sigurojë zbatimin e urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë (komunës) në lidhje me personat juridikë ose fizikë, që nuk plotësojnë konform ligjit detyrimet financiare e fiskale, ndaj bashkisë apo komunës, si dhe çdo detyrim tjetër pasuror ndaj tyre.

15.J.P, Përgjegjëse e njësisë së auditit të brendshëm publik, (në periudhë prove)

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në 5 praktika të cilat u mbikëqyrën nga grupi i auditimit të KLSH rezultoi se, nuk është zbatuar “Manuali i Procedurave të Auditimit, Kodi etik për auditët e brendshëm, karta e auditimit të brendshëm publik miratuar me urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 69, datë 29.9.2010.

-Në përfundim të auditimit nuk ka hartuar Memorandumi (informacion mbi përfundimet e kontrollit) edhe në disa raste që ishte përgatitur është identik me Raportin Final të Auditimit, si nga numri i fletëve dhe problematika,në kundërshtim me seksionit V, pika 5, Memorandumi.

-Përfundimet e auditimit nuk i janë bërë prezent Kryetarit të Bashkisë duke mos marrë mendimin e tij me shkrim. Problemet e nxjerra nuk trajtohen në mënyrë të përmbledhur (konçize) në raportin final, duke e bërë të vështirë për titullarin në marjen e informacionit dhe në vendimarrje.

-Pas shqyrtimit të praktikës së auditimit, nuk hartohet shkresa e evadimit, e cila nuk i është dërguar zyrtarisht subjektit të audituar, duke mos e shoqëruar dhe me Raportin final të auditimit edhe në ato raste kur raporti final është dërguar dorazi pa u shoqëruar me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, nuk kishte konfirmim zyrtar të Raportit Final të Auditimit, nga subjekti i kontrolluar.

-Nuk ka zbatuar Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 12, datë 5.6.2012” Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Masa Disiplinore për 10 punonjësit e Institucioneve në vartësi të Bashkisë Pogradec:

I. Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, dhe në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ***i rekomandojmë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, që nga masa “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për 3 punonjësit si më poshtë:***

I. Sektori Mbështetës i Arsimit

1. z. Z.Ç, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Arsimit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, **për shkeljet e mëposhtme:**

-Nuk ka hartuar procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me pikat 42,43,52 dhe 54 marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- në cilësinë e anëtarit të komisionin e verifikimit të sipërfaqeve të rrugëve dhe hartimin e preventivit.

-Nuk ka argumentuar volumet e shërbimit të pastrimit të qytetit të Pogradecit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2010 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 2, germa “c”, pasi nuk janë bazuar në kontratën datë 22.12.2008, e ndryshuar, për rrjedhojë janë rritur në mënyrë të paargumentuara volumit e shërbimit në vlerën 282,223 lekë.

-nuk ka argumentuar ndryshimet në volume, afate, frekuencat në zërat e shërbimeve në vlerën 2,374,169 lekë.

- Në cilësinë e ish-Kryeinspektorit të INUV, nga data 12.10.2011 deri më datën 15.07.2013, për mos nisjen e procedurave për arkëtimin e 9 gjobave në vlerën 1,440,000 lekë, nga të cilat vlera e 9 gjobave për 900,000 lekë dhe kamata vonesa për shumën 540,000 lekë.

-Veçanërisht për mos ndjekjen e procedurave të arkëtimit të vendimeve të 6 gjobave në vlerën 300,000 lekë të rekomanduara nga KLSH.

2. zj.M.Ç, me detyrë Përgjegjëse e sektorit mbështetës të arsimit, **për arsye se:**

-Nuk ka hartuar procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me pikat 42,43,52 dhe 54 marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Nuk ka përfshirë në regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve të viteve 2013 dhe 2014 prokurimet me vlerë të vogël, në kundërshtim me germën a, të pikës 2 Prokurimet me vlerë të vogël”, të kreut VI “Zhvillimi i procedurave”, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe pikës 4 të Udhëzimit të KM nr. 01, datë 01.02.2013 “Për procedurën e prokurimeve me vlera të vogla”.

II. Ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturrës

3. znj.Z.R, me detyrë Drejtore, **për shkeljet e mëposhtme:**

-Nuk ka përfshirë në regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve të viteve 2013 dhe 2014 prokurimet me vlerë të vogël, në kundërshtim me germën a, të pikës 2 Prokurimet me vlerë të vogël”, të kreut VI “Zhvillimi i procedurave”, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007“Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe pikës 4 të Udhëzimit të KM nr. 01, datë 01.02.2013”Për procedurën e prokurimeve me vlera të vogla” .

-Nuk kanë bashkëlidhur urdhër shpenzimeve praktikat e blerjeve, në kundërshtim me nenin 6 Evidenca mbështetëse, pika 1, e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

-Kanë ndryshuar vlerën limit të kontratës, në procedurën e zhvilluar, në kundërshtim me Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 7, datë 20.12.2012 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomik”, i ndryshuar.

-Nuk kanë hartuar procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me pikat 42,43,52 dhe 54 marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-në cilësinë e kryetarit të komisionin e verifikimit të sipërfaqeve të rrugëve dhe hartimin e preventivit, **edhe për shkeljet e mëposhtme:**

-Nuk ka argumentuar volumet e shërbimit të pastrimit të qytetit të Pogradecit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2010 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik:, i ndryshuar , kreu III, pika 2, germa “c”, pasi nuk janë bazuar në kontratën datë 22.12.2008 e ndryshuar, për rrjedhojë janë rritur në mënyrë të paargumentuara volumet e shërbimit në vlerën 282,223 lekë.

-Nuk ka argumentuar ndryshimet në volume, afate, frekuencat në zërat e shërbimeve në vlerën 2,374,169 lekë

- Kontratat e qirasë të Vendstrehimeve janë lidhur duke u referuar në Kodin Civil nenet 801-825 dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pa marrë parasysh VKM nr. 280, datë 15.01.1996 “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse”, të ndryshuar me VKM nr. 1001, datë 13.11.2013, pavarësisht se vlera e kontratës është në përputhje me çmimin e përcaktuar.

- Për moslidhjen e kontratave të reja për të vënë në efikasitet plotësisht apo pjesërisht ambientet e 22 vendstrehimeve, të cilat janë deklaruar në gjendje të mirë teknike e të përshtatshme për tu lëshuar me qira, duke krijuar mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë.

II. Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, kërkojmë që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, kryetari i Bashkisë Pogradec të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore,”**Vërejtje**” deri në **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për 7 punonjësit si më poshtë:**

I. Qendra Kulturore-Lasgush Poradeci

1. z. E.K, me detyrë Drejtor,

2. zj. E.Sh me detyrë Specialist i nivelit të mesëm për financën dhe kryetare i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël.

Për arsye se:

-Nuk kanë përfshirë në regjistrat e parashikimit dhe realizimit faktik, për vitet 2013 dhe 2014, prokurimet me vlera të vogël, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007“Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu I, pika 3, Buletini i Njoftimeve publike, shkronjat (b dhe d), Kreu VI-të “Zhvillimi i procedurave”, pika 2 “Prokurimet me vlerë të vogël”, shkronja (a) dhe Udhëzimin e KM nr. 1, datë 01.02.2013” Për procedurën e prokurimeve me vlera të vogla”, pika 4.

-Nuk kanë hartuar procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me pikat 42,43,52 dhe 54 marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

II.Ndërmarrja e Gjellbërimit.

3. z. Th.L., me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes, në cilësinë e titullarit të Autoritetet Kontartktor.

4. zj.V.T., me detyrë Përgjegjës i degës ekonomike, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël,

Për arsye se:

-Nuk kanë përfshirë prokurimet me vlera të vogël në regjistrat e parashikimit dhe realizimit faktik, për vitet 2013 dhe 2014, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007“Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu I, pika 3, Buletini i Njoftimeve publike, shkronjat (b dhe d), Kreu VI-të “Zhvillimi i procedurave”, pika 2 “Prokurimet me vlerë të vogël”, shkronja (a) dhe Udhëzimin e KM nr.1, datë 01.02.2013” Për procedurën e prokurimeve me vlera të vogla”, pika 4.

-Nuk kanë hartuar procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me pikat 42,43,52 dhe 54 marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

III. Ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturrës

5. znj. A.M., me detyrë Përgjegjëse e degës ekonomike specialist i nivelit të lartë dhe në cilësinë e kryetares të komisionit të blerjeve në vlera të vogla.

Për arsye se:

-Nuk kanë përfshirë në regjistrin e parashikimeve dhe realizimeve të viteve 2013 dhe 2014 prokurimet me vlerë të vogël, në kundërshtim me germën a, të pikës 2 Prokurimet me vlerë të vogël”, të kreut VI “Zhvillimi i procedurave”, të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007“Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe pikës 4 të Udhëzimit të KM nr. 01, datë 01.02.2013”Për procedurën e prokurimeve me vlera të vogla”.

-Nuk kanë bashkëlidhur urdhër shpenzimeve praktikat e blerjeve, në kundërshtim me nenin 6 Evidenca mbështetëse, pika 1, e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

-Kanë ndryshuar vlerën limit të kontratës, në procedurën e zhvilluar, në kundërshtim me Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 7, datë 20.12.2012 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomik”, i ndryshuar.

-Nuk kanë hartuar procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me pikat 42,43,52 dhe 54 marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

6. zj. D.K., me detyrë Përgjegjëse e Degës Teknike

- Kontratat e qirasë të Vendstrehimeve janë lidhur duke u referuar në Kodin Civil nenet 801-825 dhe VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pa marrë parasysh VKM nr. 280, datë 15.01.1996 “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse”, të ndryshuar me VKM nr. 1001, datë 13.11.2013, pavarësisht se vlera e kontratës është në përputhje me çmimin e përcaktuar.

IV. Klubit Shumësportësh.

7. znj. V.L., me detyrë Specialiste e nivelit të mesëm për financën, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Prokurimeve me Vlerë të Vogël, **për arsye se:**

-Nuk ka shoqëruar me faturë të printuar nga kasa elektronike fiskale, të gjitha transaksionet e kryera me faturë të thjeshtë tatimore apo faturat tatimore të shitjes me TVSH, në kundërshtim me Seksionin II, Pajisjet fiskale, neni 55 Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale pika 1 e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë”.

-Nuk ka hartuar procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave, në kundërshtim me pikat 42,43,52 dhe 54 marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, të udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

D. MASA ADMINISTRATIVE

I.Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2014, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në shkronjën “i”, të nenit 13 Agjencia e Prokurimit Publik, nenit 72 Kundërvajtjet administrative, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikës 1, të nenit 79 Sanksionet administrative, pikave 1 dhe 2 të nenit 81 Masat disiplinore, të kreut X Sanksionet administrative dhe masat disiplinore të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, **i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **16 personat e mëposhtëm:**

1. Z. A.Sh, me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë, Pogradec, në cilësinë e ish-titullarit të Autoritetit Kontraktor, për shkeljet e mëposhtme:

a.Në 5 procedurat me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratë e zhvilluara për vitin 2014, me objekt “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike”, me fond të kontraktuar gjithsejt në vlerën **30,607,592** lekë, paraqet argumentin se është në kushtet e emergjencës, argument i cili nuk qëndron, pasi është në kundërshtim me germën “c”. pika 2, Neni 33 Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nuk përmbushen asnjë nga kushtet e përcaktuara në germën “a”, pikën 5, Kreun e IV, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *pasi neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.*

b.Zgjedhja e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, në 3 tenderat me objekt: “Blerje kuote ushqimore”, në vlerën 761,200 lekë, “Blerje Karburanti” (nafte), në vlerën 2,916,660 lekë dhe Blerje lende djegëse (dru zjarri), në vlerën 909,900 lekë, është në kundërshtim me nenin 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut IV, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, *për arsye se janë ndryshuar dokumentet e të tenderit, në procedurën me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës.*

Kontratat janë lidhur në kundërshtim me nenet 1 “Objekti dhe qëllimi”, 2 “Parimet e përzgjedhjes”, 4 “Fusha e zbatimit” dhe 29 “Procedurat standarde të prokurimit”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik, për arsye se autoriteti kontraktor, *në përcaktimin e fituesit, nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara në këtë ligj, duke cenuar parimet e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë i ofertuesve dhe parimin e transparencës në procedurat e prokurimit, me pasojë favorizimin e një operatori ekonomik të caktuar të zgjedhur nëpërmjet procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.*

2.zj. M.K, me detyrë Drejtore e Drejtorisë Financës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

3. zj. M.K, me detyrë Specialiste për regjistrin e territorit dhe arkivit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në cilësinë e anëtarëve të KVO në tenderin e pastrimit të qytetit për vitin 2015-2019, kanë kualifikuar operatorët ekonomik, në kundërshtim me nenin 46 “Kualifikimi ofertuesve dhe 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreut V zhvillimi i procedurave, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kandidatët nuk plotësonin kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST.

4. Zj. I.Xh, me detyrë ish Drejtore e Drejtorisë Financë, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e mëposhtme:

-Në cilësinë e anëtares të KVO në tenderin e pastrimit të qytetit për vitin 2015-2019, ka kualifikuar operatorët ekonomik, në kundërshtim me nenin 46 “Kualifikimi ofertuesve dhe 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreut V zhvillimi i

procedurave, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kandidatët nuk plotësonin kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST.

- Në 2 raste operatorët janë shpallur fitues edhe kur nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”.

5.zj. S.Ll, me detyrë Specialiste e nivelit të lartë për legjislacionin dhe prokurimet, në cilësinë e Juristes së Njesisë së Prokurimit.

-Në cilësinë e anëtares të njesisë së prokurimit në **tenderin e pastrimit të qytetit** për vitin 2015-2019, ka përcaktuar kriteret të veçanta për kualifikim jo të sakta, jo objektive, diskriminuese dhe jo në përpjesëtim me vlerën dhe objektin e kontratës, për pasojë është favorizuar bashkimi i operatorit ekonomik “Rej & Shpresa”, **për vlerën 4,796,530 lekë.**

-Nuk ka implementuar saktë preventivin e projektit të zbatimit i objektit “Sistemim rrugësh blloku lagja 1 trekëndëshi në shtojcat 1 dhe 12 të Dokumentet Standarde të Tenderit, në vlerën 2,330,290 lekë sipas analizës 3-212/a Shtresë stabilizant t-5 cm 11710 m² x 199 lekë /m², në kundërshtim me shtojcën 11 Projekti i Zbatimit dhe shënimet teknike, për rrjedhojë ka lejuar një rritje të paargumentuar të fondit limit në vlerën **2,330,290 lekë.**

-në cilësinë e anëtares të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla për aparatin e Bashkisë, për shkeljet e mëposhtme:

-Në procedurën e prokurimit me objekt “*Stenda për fotografi(emergjenca)*”, fitues subjekti “P.B”, nuk janë respektuar procedurat normale të prokurimit.

-Në 10 raste nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime.

-Në 3 raste në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është kërkuar lloji i markës, pa shënimin e detyrueshëm “*ose ekuivalent*” në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5.

-Në 1 rast procedura e prokurimit në sistemin elektronik nuk është realizuar e plotë.

-Për mos planifikim dhe mos raportim të shumës së blerjeve në vlera të vogla në Regjistrat e Parashikimit dhe Realizimit të Prokurimeve Publike të kryera nga Sektori Mbështetës i Arsimit.

6.zj.Fillareta Buzo, me detyrë Përgjegjës e Sektorit të Aseteve Statistikës dhe Promocionit, në cilësinë Specialistes të Njesisë së Prokurimit.

7.zj. ElviraLipi, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit, Thesarit Pagës dhe Arkës dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor, në cilësinë e Specialistes së Njesisë së Prokurimit.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në cilësinë e anëtarëve të njesisë së prokurimit në tenderin e pastrimit të qytetit për vitin 2015-2019, kanë përcaktuar kriteret të veçanta për kualifikim jo të sakta, jo objektive, diskriminuese dhe jo në përpjesëtim me vlerën dhe objektin e kontratës, për pasojë është favorizuar bashkimi i operatorit ekonomik “Rej & Shpresa”, **për vlerën 4,796,530 lekë.**

-Nuk kanë implementuar saktë preventivin e projektit të zbatimit i objektit “Sistemim rrugësh blloku lagja 1 trekëndëshi në shtojcat 1 dhe 12 të Dokumentet Standarde të Tenderit, në vlerën 2,330,290 lekë, në kundërshtim me shtojcën 11 Projekti i Zbatimit dhe shënimet teknike, për rrjedhojë kemi një rritje të paargumentuar të fondit limit, **në vlerën 2,330,290 lekë.**

-në cilësinë e anëtarit të njesisë prokurimeve për vitin 2013.

-Në 3 raste në procedurat “Blerje lëndë djegëse (dru zjarri)” me kontratë datë 18.11.2013, me vlerë 999,000 leke pa tvsh, “Blerje karburanti (nafte)” me kontratë datë 19.11.2013, me vlerë 2,916,667 lekë pa tvsh, “Blerje kuote ushqimore për çerdhen e qytetit” me kontratë datë 02.05.2013, me vlerë 997,425 leke pa tvsh, ka nisur procedurën e prokurimit pa urdhrin e titullarit të autoritetit kontraktor.

-Në këto 3 procedura nuk është mbajtur dokumentet si procesverbal, raport përmbledhës, vendim i titullarit të autoritetit kontraktor për miratimin e raportit në lidhje anulimin e procedurës.

-Në 2 raste, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderit, duke favorizuar operator ekonomik të caktuar.

8.z.D.H me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Legjislacionit dhe Nënkyetar Bashkie, në cilësinë e kryetarit të KVO-së dhe Juristit të NJP.

-Në cilësinë e kryetarit të KVO në tenderin e pastrimit të qytetit për vitin 2015-2019, ka kualifikuar operatorët ekonomik, në kundërshtim me nenin 46 “Kualifikimi ofertuesve dhe 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreut V zhvillimi i procedurave, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kandidatët nuk plotësonin kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST.

-në cilësinë e antarit të njësies prokurimit në vitin 2013.

-Në 3 raste ka nisur procedurën e prokurimit pa urdhrin e titullarit të autoritetit kontraktor duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 1, shkronja “a” dhe “ç”.

-Në 3 procedura nuk janë mbajtur dokumentet si procesverbal, raport përmbledhës, vendim i titullarit të autoritetit kontraktor për miratimin e raportit në lidhje anulimin e procedurës, duke shkelur kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, pika 1, shkronja “c”, pika 2 shkronja “a” dhe “c”.

-Në 4 raste në procedurat përzgjedhja e procedurës e prokurimit me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, pika 5, pasi në 3 raste janë ndryshuar kushtet fillestare dhe dokumentet e tenderit, kriteret e veçanta për kualifikim kapaciteti ekonomik-financiar dhe ai teknik nuk janë të njëjta me dy procedurat e para të anuluar, ndërsa në një rast nuk jemi në kushtet e një nevojë ekstreme të shkaktuar nga një ngjarje e paparashikuar.

-Në 2 raste kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës me çmimin më të ulët nuk i plotësojnë kushtet e nenit 55, pika 1, e LPP-së, pasi nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderit, duke favorizuar operator ekonomik të caktuar.

-Në 1 rast në procedurën “Blerje kuote ushqimore për çerdhen e qytetit(emergjenca)” me kontratë datë 19.03.2013, me vlerë 127,575 lekë pa tvsh, procedura nuk është pasqyruar në regjistrin e realizimit të prokurimeve të dërguar në APP, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu I, pika 3, germa “d” Raportimi i Realizimi të Prokurimit Publik.

9. R.S, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Turizmit, dhe anëtar e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave **dhe,**

10.E.M me detyrë Specialist i nivelit të lartë për supervizim shërbimesh si dhe anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **për shkeljet e mëposhtme:**

- Në 3 raste në procedurat “Blerje lëndë djegëse (dru zjarri)” me kontratë datë 18.11.2013, me vlerë 999,000 leke pa tvsh, “Blerje karburanti (naftë)” me kontratë datë 19.11.2013, me vlerë 2,916,667 lekë pa tvsh, “Blerje kuote ushqimore për çerdhen e qytetit” me kontratë datë 02.05.2013, me vlerë 997,425 leke pa tvsh, operatorët janë shpallur fitues edhe kur nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”.

-Për mangësitë e shfaqura në blerjet me vlera të vogla në Aparatin e Bashkisë, trajtuar më hollësisht në pikën faqe të Raportit Përfundimtar të Auditimit .

Për 6 anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlëra të Vogla për Sektorin Mbështetës të Arsimit.

11.V.L, me detyrë Specialist i nivelit të mesëm për financën, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla për Sektorin Mbështetës të Arsimit zëvendësuar me urdhrin nr. 54, datë 01.04.2013,**për shkeljet e mëposhtme:**

- Në 2 raste nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël”, shkronja “b” dhe UMF, nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, dhe 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në 2 raste urdhri i prokurimit nuk është firmosur nga titullari i autoritetit kontraktor në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, “Prokurimi me vlerë të vogël”, germa “b” dhe Udhëzimin nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 5.

- Në 2 raste nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar kreut II, pika 2- Llogaritja e vlerës së kontratës, shkronja “c” dhe “ç”.

12. I.T, me detyrë Specialist i Nivelit të Lartë për Arsimin parauniversitar, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla për Sektorin Mbështetës të Arsimit, nga data 01.04.2013-21.03.2014, **për shkeljet e mëposhtme:**

- Në 3 raste nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit dhe testimin e tregut në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar kreut II, pika 2- Llogaritja e vlerës së kontratës, shkronja “c” dhe “ç”.

- Në 4 raste nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël”, shkronja “b” dhe UMF, nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, dhe 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në 2 raste në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është kërkuar lloji i markës, pa shënimin e detyrueshëm “ose ekuivalent” në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5.

13. E.H me detyrë Specialiste e Nivelit të Lartë për Arsimin parashkollor, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla për Sektorin Mbështetës të Arsimit, për vitin 2013, **për shkeljet e mëposhtme:**

- Në 2 raste urdhri i prokurimit nuk është firmosur nga titullari i autoritetit kontraktor në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, “Prokurimi me vlerë të vogël”, germa “b” dhe Udhëzimin nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 5.

- Në 7 raste nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël”, shkronja “b” dhe UMF, nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, dhe 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në 3 raste nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit dhe në 1 rastë procesverbal për testimin e tregut, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar kreut II, pika 2- Llogaritja e vlerës së kontratës, shkronja “c” dhe “ç”.

14. A.B, me detyrë Specialiste e Nivelit të Lartë Arsimin parashkollor, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla për Sektorin Mbështetës të Arsimit, për vitin 2014, **për shkeljet e mëposhtme:**

- Në 5 raste nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël”, shkronja “b” dhe UMF, nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, dhe 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në 6 raste nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit dhe në 3 raste procesverbal për testimin e tregut, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar kreut II, pika 2- Llogaritja e vlerës së kontratës, shkronja “c” dhe “ç”.

- Në 1 rast në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është kërkuar lloji i markës, pa shënimin e detyrueshëm “ose ekuivalent” në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5.

15. S.A, me detyrë Specialiste e Nivelit të Lartë/Ekonomiste për arsimin, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla për Sektorin Mbështetës të Arsimit, për vitin 2014, **për shkeljet e mëposhtme:**

- Në 6 raste nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël”, shkronja “b” dhe UMF, nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, dhe 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në 8 raste nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit dhenë 3 raste procesverbal për testimin e tregut, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar kreut II, pika 2- Llogaritja e vlerës së kontratës, shkronja “c” dhe “ç”.

- Në 2 raste në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është kërkuar lloji i markës, pa shënimin e detyrueshëm “ose ekuivalent” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5.

- Në 1 rast procedura e prokurimit në sistemin elektronik nuk është realizuar e plotë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 20.12.2012 dhe Udhëzim e APP nr.4, datë 04 .07 .2013- “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë.”.

16. M.Ç me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Mbështetës të Arsimit si dhe anëtare e Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla për Sektorin Mbështetës të Arsimit, **për shkeljet e mëposhtme:**

- Në 16 raste nuk ka kërkesa nga personat përgjegjës për nevojat për mallra, punë dhe shërbime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, “Prokurim me vlerë të vogël”, shkronja “b” dhe UMF, nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, dhe 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në 14 raste nuk ka procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit dhe në 4 raste procesverbal për testimin e tregut, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar kreut II, pika 2- Llogaritja e vlerës së kontratës, shkronja “c” dhe “ç”.

- Në 2 raste urdhri i prokurimit nuk është firmosur nga titullari i autoritetit kontraktor, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, “Prokurimi me vlerë të vogël”, germa “b” dhe Udhëzimin nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 5.

- Në 2 raste në përcaktimin e specifikimeve teknike për mallrat nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është kërkuar lloji i markës, pa shënimin e detyrueshëm “ose ekuivalent”, në kundërshtim me

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”, pika 5.

- Në 1 rast procedura e prokurimit në sistemin elektronik nuk është realizuar e plotë, në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 7, datë 20/12/2012 dhe Udhëzim nr.4, datë 04 /07 /2013- “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë.”(Dhe për shkeljet e tjera të trajtuar më hollësisht në pikën 6 faqe 74-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Nga Bashkia Pogradec, është kthyer përgjigje me shkresë nr. 1204/12, datë 25.06.2015 së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në process vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Niko Nako, Ryisin Xhaja, Besmir Pajaj, Shefki Jaupi, Qemal Shehu dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT